



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:045837

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05644223

KE.nr.2589/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen juridike të paditësit Adidas AG, Adi – Dassler-Strasse 1-2, Herzogenaurach, Gjermani, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve ‘Vokshi & Lata’, kundër të paditurit “MEGKOS TRANS” SH.P.K., me NUI: 811908518, me seli në rrugën “Vasil Andoni”, në Prishtinë, me objekt kontesti shkelje e markës tregtare, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik me datë 25.04.2024, në prani të përfaqësuesit të palës paditëse dhe në mungesë të palës së paditur, me datë 30.04.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Adidas AG dhe VËRTETOHET se i padituri “MEGKOS TRANS” SH.P.K., përmes importimit të 80 palë patike, ka shkelur markat tregtare të regjistruara të paditësit “Adidas”.
- II. I NDALOHET të paditurit që në të ardhmen të importoj apo në çfarëdo forme të tregtoj mallra që shkelin markat tregtare të paditësit “Adidas”.
- III. LEJOHET shkatërrimi i 80 palë patike “Adidas”, që shkelin markën tregtare të paditësit dhe OBIGOHET i padituri që nën mbikëqyrjen doganore të bëjë shkatërrimin e mallit, në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.
- IV. OBLIGOHET i padituri që të mbuloj të gjitha shpenzimet e transportit, ruajtjes dhe magazinimi të mallrave si në pikën I të dispozitivit, në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

- V. DETYROHET i padituri “MEGKOS TRANS” SH.P.K., që paditësit, t’ia paguaj gjjobën në shumën prej 5,000.00 € (pesë mijë euro) për shkak të shkeljes së markave tregtare të regjistruara të paditësit “Adidas”.
- VI. DETYROHET i padituri që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 424.00 € (katërqind e njëzet e katër euro), në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësi Adidas AG, përmes të autorizuarit të tij, me datën 24.10.2022, ka paraqitur padi pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës – Departamenti për Çështje Ekonomike, për shkelje të markës tregtare kundër të paditurit “MEGKOS TRANS” SH.P.K., me të cilën ka kërkuar që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadija e paditësit dhe të vërtetohet se: i padituri ka shkelur markat tregtare të paditësit me numër regjistrimi 011824 dhe 011820; të i ndalohet të paditurit që në të ardhmen të importoj apo në çfarëdo forme të tregtoj mallra që shkelin markat tregtare të paditësit Adidas; të lejohet shkatërrimi i mallrave – 80 palë patike, që shkelin markat tregtare të paditësit; të obligohet i padituri që nën mbikëqyrjen doganore të shkatërroj të gjitha mallrat e lartcekura; të obligohet i padituri që të mbuloj të gjitha shpenzimet e transportit, ruajtjes dhe magazinimi të mallrave si në pikën I të dispozitivit; të obligohet i padituri që paditësit të ia kompensoj dëmin e shkaktuar për shkak të dëmtimit të imazhit të markës tregtare, si dhe t’i paguaj në tërësi shpenzimet e procedurës kontestimore në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm. Në seancën e mbajtur me datë 03.04.2024, është tërhequr nga pika V e padisë sa i përket kompensimit të dëmit dhe ka kërkuar që i padituri të paguaj ndëshkimin në shumën prej 5000 €.

E autorizuara e paditësit gjatë seancës së shqyrtimit kryesor si dhe në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë kërkesave të paraqitura me padi, duke theksuar se i padituri me rastin e tentimit të importimit të 80 palë patika ka shkelur markat tregtare të paditësit. Ka shtuar se paditësi lidhur me ndalimin e këtyre mallrave është njoftuar nga Dogana e Kosovës përmes njoftimit me numër të rastit 392/2022 të datës 27.09.2022, me ç’rast paditësi menjëherë ka bërë verifikimin e mallrave dhe e ka vërtetuar se të njëjtat janë të falsifikuara, dhe duke qenë se mallrat ende gjenden në depot doganore përveç kërkesave të tjera ka kërkuar edhe lejimin e shkatërrimit të mallrave kontestuese me shpenzimet e të paditurit, pasi

që i njëjti ka importuar mall të falsifikuar i cili është prodhuar pa leje dhe pa licencën e paditësit si pronar i markave tregtare. Gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadia e paditësit të aprovohet si e bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe i ka specifikuar.

Gjykata lidhur me këtë çështje juridike, ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor me datën 25.04.2024, në të cilën seancë ka qenë e pranishme përfaqësuesja e autorizuar e paditësit, ndërsa nuk ka qenë i pranishëm i padituri, i cili ftesën për seancë e shqyrtimit kryesor e ka pranuar në mënyrë të rregullt me datën 17.04.2024, mirëpo në seancë nuk ka prezantuar dhe mungesën nuk e ka arsyetuar.

Gjykata me propozimin e përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse në bazë të nenit 423 par. 4 të LPK-së, i cili përcakton se *“Po që se në seancën për shqyrtim kryesor nuk vjen i padituri që është thirrur rregullisht, atëherë shqyrtimi kryesor i çështjes bëhet pa praninë e tij”*, ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor në mungesë të palës së paditur.

Për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në shqyrtimin kryesor ka bërë administrimin e provave si në vijim: Vendimi i datës 04.12.2019, për vazhdimin e regjistrimit të markës tregtare me numër 11820, numër aplikimi KS/M/2010/228 të datës 22.03.2010; Vendimi i datës 04.12.2019, për vazhdimin e regjistrimit të markës tregtare me numër regjistrimi 11824, numër aplikimi KS/M/2010/225 të datës 22.03.2010; Njoftimi nga Dogana e Kosovës, rasti 392-2022 Adidas, i datës 27.09.2022, si dhe konfirmimi për falsifikimin rasti 392/22 i datës 28.09.2022.

Deklarimet e paditësit si dhe provat tjera të prezantuara dhe të administruara, gjykata i vlerësoi të gjitha një nga një dhe në varësi me njëra tjetrën, në vështrim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e bazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas Vendimit të datës 04.12.2019, për vazhdimin e regjistrimit të markës tregtare me numër 11820, numër aplikimi KS/M/2010/228 të datës 22.03.2010 dhe Vendimit të datës 04.12.2019, për vazhdimin e regjistrimit të markës tregtare me numër regjistrimi 11824, numër aplikimi KS/M/2010/225 të datës 22.03.2010, vërtetohet se paditësi ka të regjistruar pranë Agjencisë së Pronësisë Industriale dhe është pronar i markës tregtare figurative dhe markës

tregtare verbale “Adidas” dhe bartës i të drejtës së markës tregtare për produktet dhe shërbimet nga Klasat 9, 14, 18, 25 dhe 28 e Klasifikimit të Nicës.

Sipas Njoftimit nga Dogana e Kosovës Rasti 392-2022 Adidas, i datës 27.09.2022, vërtetohet se mallrat kontestuese të paditurit janë ndaluar nga Dogana nën dyshimin për shkelje të së drejtës së markave tregtare të paditësit.

Gjykata pas shqyrtimit të secilës provë veç e veç dhe të gjitha provave së bashku, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, sepse shenja që është përdorur në produktet e të paditurit është identike me markën tregtare të paditësit dhe se në rastin konkret shenjat e përdorura në mallrat e të paditurit nuk ka asnjë dyshim se shkaktojnë konfuzion në publik dhe secili konsumator do të krijoj bindjen se bëhet fjalë për produktet e paditësit.

Sipas nenit 9 të Ligjit Nr. 08/L-075 për Markat Tregtare (LMT) i aplikueshëm në rastin konkret, të drejtat nga markat tregtare konsiderohen të drejta pronësore dhe të njëjtat përbëjnë të drejta absolute. Kjo nënkupton se të gjitha palët e treta obligohen që të përmbahen nga përdorimi i paautorizuar i markës tregtare të regjistruar. Titullar i markës tregtare mund t'i ndalojë palët e treta që pa pëlqimin e tij të përdorin shenjen identike ose të ngjashme për mallrat apo shërbimet të llojit të njëjtë ose të ngjashme. Me regjistrimin e një marke të caktuar, bartësi i markës tregtare fiton të drejtën ekskluzive mbi markën tregtare.

Bartësi i markës së regjistruar tregtare gëzon një numër të drejtash me regjistrimin e markës tregtare. Sipas LMT, bartësi i markës së regjistruar tregtare ka drejta të: ndalojë përdorimin e paautorizuar të markës tregtare të tij përmes mjeteve juridike në dispozicion, të përdorë markën e regjistruar në tregun e Kosovës, si dhe të disponojë me markën tregtare të tij. Mbajtësi i një marke tregtare sipas nenit 9 të LMT-së, ka të drejtë të ndalojë: vendosjen e markës së mbrojtur, në mallra, në paketim ose etiketat e mallit; ofrimin e mallrave, vendosjen e tij në treg apo ruajtjen e tij për këto qëllime, apo ofrimin e shërbimeve nën markën tregtare të tij; importimin, eksportimin ose transitin e mallrave nën markën tregtare dhe përdorimin e markës së mbrojtur në dokumentet zyrtare ose për reklama.

Përdorimi i paautorizuar i një marke tregtare, si e drejtë ekskluzive e pronarit të saj, përbën shkelje të markës tregtare. Sipas nenit 9 të LMT-së, shkelja mund të bëhet me çdo veprim të ndërmarrë pa autorizimin e pronarit, me të cilin atakohet të paktën njëri prej të drejtave të

pronarit të markës tregtare. Kjo shkelje mund të bëhet gjatë kohës së vlefshmërisë së markës tregtare, brenda territorit për të cilën ajo është e autorizuar.

Në rastin konkret, nga shkresat e lëndës rezulton si jokontestues fakti se importimi i mallrave kontestuese nga i padituri, të cilat nuk janë mallra të prodhuara nga paditësi, e në të cilat mallra është përdorur shenja identike me markat tregtare të regjistruara të paditësit, përbën shkelje të markës tregtare.

Prandaj duke u nisur nga të sipër cekurat dhe nga fakti se në shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike, gjykata ka konstatuar se i padituri përmes importimit të mallrave: 80 palë patika me datën 27.09.2022, ka shkelur markat tregtare të paditësit të regjistruara sipas numrave 011824 dhe 011820.

Vendimin për shqiptimin e dënimit me gjobë dhe vendimin për shkatërrimin e produkteve me shpenzimet e të paditurit gjykata e morri konform dispozitave të nenit 75 par. 4 dhe 92 par. 5 të Ligjit Nr. 08/L-075 për Markat Tregtare i Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452.1 të LPK-së. Në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i të paditurit, i referohen shumës së precizuar si në pikën VI të dispozitivit të aktgjykimit, e cila përfshin shpenzimet procedurale të kërkuara dhe të provuara nga paditësi me zbatimin e rritjes prej 100% për shkak të kontestit me element të huaj sipas tarifës së OAK dhe atë për përpilimin e padisë shumë prej 104 €, për taksën gjyqësore shumë prej 50.00 € si dhe përfaqësim në një seancë gjyqësore shumë prej 270.00 €, në shumë të përgjithshme prej 424.00 €.

Nga arsyet e cekura më lart dhe në bazë të nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.2589/22, datë 30.04.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.